



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
**INSTITUTI I SIGURISË USHQIMORE DHE VETERINARISË**

**Misioni**

ISUV ka si mision të garantojnë konsumatorin në të gjitha hallkat e zinxhirit ushqimor sipas qasjeve "Nga Ferma në Tavolinë" dhe "Një Shëndet"

Në këtë kontekst ISUV është angazhuar:

- të përmirësojë strukturën analitike drejt validimit dhe akreditimit të shërbimeve;
- të zgjidhë pasiguritë gjatë survejancës së sëmundjeve të kafshëve, agjentëve zoonotike, rezistencës antimikrobike, dhe të shpërthimeve të sëmundjeve në njërëz;
- të koordinojë zbatueshmërinë e metodave të provës bazuar në rregulloret, ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare;
- të organizojë trajnime formimi dhe testime krahasuese;
- të japë vazhdimisht mbështetje teknike që autoritetet kompetente të vlerësojnë/menaxhojnë komunikojnë me efikasitet riskun.

**Veprimtaria**

ISUV e ushtron veprimtarinë si më poshtë vijon:

- a) Kryerjete analizave të sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve;
- b) Kryerjen e aktiviteteve të mjeksisë veterinarë;
- c) Kryerjen e vlerësimeve shkencore dhe kërkimeve teknologjike.

**Qëllimi dhe baza ligjore**

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë e ushtron veprimtarinë e tij bazuar në:

- Ligjin Nr.10465, datë 29/09/2011 “Mbi Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin Nr.9863, datë 28/1/2008 “Për Ushqimin” (i ndryshuar);
- Ligjin Nr.105/2016, datë 14/10/2016 “Për Mbrojtjen e Bimëve”;

- Ligjin Nr.152/2013 “Për Nënpunësin Civil”, i ndryshuar;
- Ligjin Nr.7961 datë 12/07/1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar;
- Ligjin Nr.90/2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore”;
- Ligjin Nr.9367 datë 07/04/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- Ligjin Nr.44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”; Ligji Nr.10221 datë 04/02/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”;
- Ligji Nr.9131 datë 08/09/2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”;
- VKM Nr. 732, datë 16.11.2022 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë”;
- Urdhëri Nr. 10 datë 26.01.2023 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së ISUV-së”;
- Çdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor të nxjerrë në zbatim.

Kjo rregullore i shtrin efektet mbi të gjithë punonjësit e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

#### **Financohet nga:**

- Kontributet e buxhetit të shtetit;